



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 402, datë 07.10.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËS SË SKEMËS SË DELEGIMIT
ZNJ.{...}, NË GJYKATËN E APELIT DURRËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës aktuale dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Durrës, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën deri më datë 07.10.2021.
2. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Durrës për periudhën deri më datë 15.11.2020.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Durrës.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së skemës së delegimit, znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Durrës.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR